

VENDIM
Nr. 114, datë 24.2.1997

**PËR LEJIMIN E EKSPORTIT TË 720 M³ ELEMENTE DRURI, GJYSMË TË
PËRPUNUARA, GJENDJE, TË PRODHUARA NGA SHOQËRIA “LIBADEKO” SHPK
LIBRAZHD**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të lejohet eksporti i 720 m³ elemente druri, gjysmë të përpunuara, gjendje, të prodhuara para hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.121, datë 12.2.1996, nga shoqëria “LIBADEKO”, Librazhd.
2. Ngarkohen Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe bashkia e Librazhdit për verifikimin e kësaj gjendjeje dhe, mbi bazën e procesverbalit të hartuar nga përfaqësuesit e tyre, të kryhet eksporti i kësaj sasive.
3. Eksportimi i kësaj sasive të elementeve të drurit të kryhet brenda datës 30 prill 1997.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi